



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 115/ 2011

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga, Muhamet Rexha kryesues, Xhevdet Abazi dhe Rafet Haxhaj, anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Xhavit Uka kandidat për deputet në Kuvendin e Kosovës nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës LDK seli në Prizren, të paraqitur për shkak të parregullsive gjatë procesit të numërimit në QNR, në seancën e panelit të mbajtur më 02.02.2011, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e Xhavit Uka kandidat për deputet në Kuvendin e Kosovës nga radhët e subjektit politik LDK .

A r s y e t i m

Me datën 31.01.2011 PZAP ka pranuar një ankesë nga Xhavit Ulka, në të cilën pretendohet se dyshon se gjatë rinumërimit të votave në QNR apo gjatë futjes së të dhënave në kompjuter është dëmtuar me qëllim apo pa qëllim nga punëtorët e QNR-së për gjithsej 591 vota përkatësisht 325 vota në Komunën e Prizrenit dhe 266 në Komunën e Rahovecit. Ai shton se në sipas KKZ në Prizren ka pasur 3507 vota kurse sipas rezultateve përfundimtare të publikuara më 30.01.2011 nga KQZ i ka 3182 vota dhe kështu që pretendon se është bërë manipulim me 325 vota në Komunën e Prizrenit si dhe sipas KKZ-së së Rahovecit ka pasur 2506vota kurse sipas rezultateve përfundimtare të publikuara i ka 2240 po ashtu mendon se edhe në këtë komunë janë manipuluar votat e tij gjithsej 266 vota.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur listën e rezultateve nga QV e Prizrenit dhe të Rahovecit.

Neni 118 paragrafi 1 i LZP-së, specifikon

118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet.

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 3.6, pika (b) dhe (c) parashohin si vijon:

b) një përshkrim të hollësishëm, duke përfshirë datën, kohën dhe vendin e shkeljes së pretenduar.

- c) *hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi të tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku mund të gjenden dëshmitë, në rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të ankuesit.*

PZAP pasi shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lendes gjeti se:

- **ankesa është e pabazuar.**

Për te vërtetuar faktin e pretenduar nga parashtruesja e ankesës PZAP i beri një kërkesë KQZ-së më datë 31.01.2011, për sqarimin e pasqyrimin jo real të rezultateve përfundimtare, dhe KQZ iu përgjigj kësaj kërkesë për sqarim me datë 01.02.2011, duke njoftuar se procesin e votimit dhe përpilimit të rezultateve të zgjedhjeve për Kuvendin e Kosovës 2010/2011 e ka përshkruar një proces i gjatë dhe gjithëpërfshirës i kontrollimit, auditivit dhe verifikimit të saktësisë së të dhënave dhe rezultateve. Për shkak të mospërputhjeve të konstatuara numrit të fletëvotimeve mbi nivelin e zgjedhjeve të 12 dhjetorit 2011, 92 VV në zgjedhjet e 09 janarit 2011 dhe 38 VV në zgjedhjet e 23 janarit 2010.

Në rezultatet përfundimtare të QNR-së të shpallura nga KQZ-ja me 30 janar 2011 është përfshirë edhe numri i votave me kusht, votave të votimit përmes postës dhe atyre me nevoja te veçanta. Procesi i rinumërimit të votave në këto VV ka qenë transparent dhe është zhvilluar në praninë e vënguesve të subjekteve politike të certifikuara, medieve, faktorit ndërkombëtar si dhe në bashkëpunim me këshilltarët e IFES-it. Mbi bazën e gjithë këtij procesi janë prodhuar rezultatet e QNR-së të shpallura nga KQZ me 30 janar 2011.

PZAP shqyrtoi Listat e VV të rinumëruara sipas vendimeve përkatëse të KQZ-së dhe Master Lista me QV për zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës 2010 dhe erdhi në përfundim se parregullsite e pretenduara janë eliminuar gjate rinumerimit dhe auditimit nga KQZ-ja. Si rrjedhim, PZAP konstatoj se pretendimet e parashtruesit te ankeses jane korrigjuar dhe pere kete arsye e refuzoi ankesen si te pabazuar. PZAP-i duke u bazuar në arsyet e cekuara më lartë e po ashtu në pajtim më dispozitat e cituara ligjore si dhe në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendim.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në Prishtinë

A nr. 115/2011 më datën 02.02.2011.

**Kryesuesi i Panelit
Muhamet Rexha**

